



Datë: 25.11.2022

Në bazë të nenit 63 par 3.2 të Ligjit nr. 03/L/163 për Miniera dhe Minerale, dhe në bazë të Ligjit Nr. 06/L – 114 për Zyrtarët Publikë, në pajtim me dispozitat e paragrafit 6 dhe 7 të nenit 10 të Rregullores (QRK) nr. 01/2022 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues, Njësia e Burimeve Njerëzore në Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale me datë 25.11.2022 bënë:

SHPALLJE PUBLIKE

për pranimin e propozimeve nga organizatat e specializuara për ekspert të jashtëm të Komisionit të Pranimin

Organizatat e specializuara-ofruesit jo publik të shërbimeve të punësimit, OJQ-të dhe/apo kompanitë e regjistruara në Republikën e Kosovës në fushën e burimeve njerëzore kanë të drejtë që të dërgojnë propozimet e tyre për ekspert të jashtëm/anëtar të Komisionit të Pranimin në KPMM për pozitën Kryeinspektor i Minerave në KPMM.

Kandidatët për anëtarë të Komisionit të Pranimin (ekspertët e jashtëm) të propozuar nga organizatat e specializuara, në pajtim me dispozitat e paragrafit 6 të nenit 9 të Rregullores (QRK) nr. 01/2022 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues, duhet t'i plotësojnë kriteret si në vijim:

1. të kenë diplomë universitare të paktën 240 kredi;
2. të kenë tetë (8) vite përvojë pune profesionale prej të cilave të paktën pesë (5) vite në pozita të nivelit drejtues;
3. të mos kenë qenë anëtarë të organeve drejtuese të ndonjë partie politike të paktën në pesë (5) vitet e fundit;
4. të kenë integritet moral dhe profesional;
5. të mos kenë aktakuzë të konfirmuar dhe të mos kenë qenë të dënuar për kryerjen e një vepre penale;
6. të mos jetë i punësuar në shërbimin civil, të mos jetë i larguar nga shërbimi civil si rrjedhojë e masave disiplinore dhe të mos kenë masa disiplinore në fuqi.

Për kandidatët e propozuar nga organizatat e specializuara, duhet të dorëzohen dokumentet në vijim:

- Biografinë (CV-në);
- Dëshminë e kualifikimit profesional (diplomën e fakultetit). Për diplomat e pranuar jashtë vendit duhet të bashkëngjitet nostrifikimi i diplomës;
- Dëshmitë për përvojën profesionale dhe përvojën menaxheriale në pozitat e nivelit drejtues;
- Deklaratën me shkrim që nuk ka qenë anëtar i organeve drejtuese të ndonjë partie politike të paktën në pesë (5) vitet e fundit;
- Certifikatën e gjendjes penale të lëshuar nga gjykata kompetente;

Rr. Armend Daci Nr.1
Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 (38) 240 252
Fax: +383 (38) 245 844
E-mail: ICMM@kosovo-mining.org
Web: www.kosovo-mining.org

Kuvendi i Kosovës
Skupština Kosova
Assembly of Kosovo

- Deklaratën me shkrim që nuk është i punësuar në shërbimin civil, që nuk është i larguar nga shërbimi civil si rrjedhojë e masave disiplinore dhe që nuk ka masa disiplinore në fuqi;
- Kopjen e letërnjoftimit ose të pasaportës.

Organizatat e specializuara duhet të dërgojnë dëshminë zyrtare me të cilën dëshmojnë përmbushjen e kriterëve për statusin e organizatës së specializuar (ofruesit jo publik të shërbimeve të punësimit, OJQ-së dhe/apo kompanisë së regjistruar në Republikën e Kosovës) në fushën e burimeve njerëzore, si dhe duhet të ofrojnë të dhënat e sakta për adresën dhe numrin e telefonit kontaktues.

Për të gjithë të interesuarit ofrohen mundësi të barabarta dhe inkurajojmë të gjitha organizatat e specializuara që i plotësojnë kriteret e shpalljes të dërgojnë propozimet e tyre për anëtar të Komisionit të Pranimit.

Sipas pikës 5 të nenit 41 e Ligjit Nr. 06 L-114 Për Zyrtaret Komisioni i pranimit për pozita të kategorisë së lartë drejtuese, që themelohet në çdo institucion tjetër shtetëror, është ad hoc.

Anëtari i Komisionit si ekspert i jashtëm në Komisionin e Pranimit, përfiton një pagesë fikse prej dyqind e pesëdhjetë (250.00) Euro për çdo procedurë konkurrimi në të cilën merr pjesë, në pajtim me dispozitat e nenit 11 të Rregullores (QRK) Nr. 01/2022 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues.

Afati për dorëzimin e propozimeve për ekspert të jashtëm në Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale, është i hapur nga data 29/11/2022 deri më datë 05/12/2022.

Organizatat e specializuara të gjitha propozimet e tyre me dokumentet e bashkëngjitura mund t'i dërgojnë përmes postës elektronike në e-mail adresën: fmulaj@kosovo-mining.org.

Për informata shtesë mund të kontaktoni në nr. tel: 038-240-252-203 ose në email adresën: fmulaj@kosovo-mining.org.

Ju faleminderit!

Sali Mula
Zëvendësues i Drejtorit
Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale

